

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 25.06.2026, ora 01:16 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Elsid Zyma dhe Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Të nderuar kolegë, I nderuar Zv. kryetar mirëseerdhët në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak datë 25.06.2026. Ftoj sekretarin të bëj apelin.

Elsid Zyma-Sekretar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Bën apelin. Prezent janë 32 prezent.

Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkika Elbasan

Para tre muajësh ju kam dërguar një kërkesë, dhe sot gjej në dosje përgjigjen me datën 27 mars ndërko që sot jemi 27 qershor, pra tre muaj me vonesë përgjigjja për një anëtar të këshillit bashkiak. E dyta kërkoj vëmëndjen tuaj dhe të sekretarjatit të këshuillit që kur lëshin document zyrtar me vulë të njomë të shikoj mirë regjistrat e kësaj bashkie për vitin 2025 më keni sjellë në përgjigje vetëm një vendim ndërkohë që janë 5 I kam numëruar, po vijoni në mënyrë antiligjore me rendin e ditës me qështjen e paketës së maleve, ndërkohë që nuk ka ngelur njeri në shqipëri I madh dhe I vogël pa mësuar që qytetarët e këtij vëndi dhe jo vetëm janë duke e kundërshtuar me forcë këtë gje. Si anëtar I këshillit bashkiak jus jell në vëmëndje cdo lloj hapi abuziv që po kryeni ju dhe bashkia Elbasan, do të jetë object I ankesave gjyqsore nga unë si anëtar këshilli dhe besoj nga të gjithë qytetarët. Paketa e maleve që fusni në rendin e këshillit Bashkiak sic bëtë herën e kaluar që e keni kaluar në mënyrë antiligjore se do 31 vota, sic po veproni me projektin e kalasë, po ju them dhe një herë tjetër sillni këshillin bashkiak në ligjshmëri

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Për sa I përket asaj të parës unë e iqë përgjigjen e ke marrë dhe në formë elektronike. Për sa I përket rendit të ditës, ajo që ne ju kemi dhënë ju është me 7 pika dhe sot është me 6 pika sepse në komisione që ne diskutuam dhe kjo nuk është faji

im që ju nuk merrni pjesë në mbledhjet e komisioneve. Në mbledhjet e komisioneve duhet të kishit ardhur e kam për të gjithë në përgjithësi. Z. Muzhaqi tha që nëse doni të më dëgjoni kam një propozim ta heqim nga rendi I ditës pikën Posedue jopronarë, mos ta trajtojmë këtë mbledhje. Në si kryesi e gjykuam dhe e hoqëm nga rendi I ditës.

Erion Murataj-Anëtar i Këshillit Bashkik Elbasan

Jeni në shkelje të ligjit, dhe rregullores të këtij këshilli Bashkik dhe për listën që pretendohet që keni kaluar.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkik Elbasan

Tek rendi I ditës është hequr Paketa e maleve, plus kësaj tek të ndryshmet kërkohet një projekt vendim nga financa, buxheti e kanë por do ta cilsojmë me zë blerje kondicioneri.

Valbona Balliu-Anëtare e Këshillit Bashkik Elbasan

Pikës e pari kur është bërë projekti I kalasë, unë di që ky është parlamenti I qytetit.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkik Elbasan

Hapet votimi, ke të ndryshmet thuaj çfarë të duash.

(Këshilli Bashkik bën 5 min pushim)

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkik Elbasan

Ne jemi parlatamenti, I Bashkisë së Elbasanit dhe jemi përfaqësues I të gjithë forcave politike kemi dhe pozitë dhe opozitë, jemi dhe live dhe duhet të merremi vesh me njëri tjetrin por jo s'do të thotë që dikush të bërtasi dhe dikush të flasi, të respektojmë radhën dhe njëri tjetrin. Kushdo që e merr fjalën pa leje dhe pa u hapur mikrofoni nuk do të regjistrohet. Sot mund të tërhiqim vërejtjen shoqërore anëtares, koleges tonë por s'është mirë që të përsërisim debate pa sens midis njëri tjetrit.

Ergys Muzhaqi-Anëtar i Këshillit Bashkik Elbasan

E kam një farë pakënaqësie ndaj jush, ju duhet ta menaxhoni më mirë mbledhjen në përgjithësi dhe rastin në fjalë. Në rendin e ditës në momentin e fundit keni futur një pikë tek të ndryshmet dhe keni hequr një pikë që lidhet me paktën e maleve për të

cilën nuk jemi lajmëruar, është qëndrimi im personal dhe jo si pjesë e grupit të opozitës pas komunikim personal që kam pasur me propozuesin e kësaj pike që ka të bëjë me instalimin e dy kondicionerëve në teatrin skampa por që ka të bëjë me fondin e drejtorisë së sportit sipas informacionit që mora. Kërkoht nga drejtoria në fjalë sic e keni pasqyruar këtu që të një pjesë e atij fondi që ai ka për një aktivitet tjetër të kalohet për kondicionimin e tetarit qëndrimi im personal jo për precedent se është I gabuar mënyra se si futete por për rastin konkret unë do të mbaj qëndrim pozitiv në emrin tim personal. për procedurë e keni bërë gabim keni hequr një pikë pa na lajmëruar dhe keni shtuar një pikë gjysëm ore para mbledhjes.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Në pikën 81 të rregullores së Këshillit Bashkiak në rendin e ditës një pikë është hiqet dhe shtohet pyeten Këshilltarët por kur ajo merr shumicën e votave. Dhe si rregull cdo vendim duhet 5 ditë përpara që të diskutohet, por është një pikë që nëse ne do të mblidheshim pas një muaji nuk besoj që kishte ndonjë ndikim pasi ishin fondet e të njëjtës drejtori dhe e lashë tek të ndryshmet.

Ergys Muzhaqi-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Drejtoritë duhet ta sjellin në kohën e duhur materialin.

Pika 1 e rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës.

Këshilli Bashkiak me 26 vota pro, 4- kundër, 4 - abstenim, miraton sa më sipër.

V.K (V.Balli,D.Madhi,E.Murataj,R.Mita)

V.A (Y.Balliu,B.Copja,A.Kana,E.Muzhaqi)


Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala




Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 25.06.2026, ora 01:16 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Elsid Zyma dhe Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Pika 2 e rendit të ditës

2. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së rradhës së muajit Maj e zhvilluar më datë 04.06.2026.

Këshilli Bashkiak me 25 vota pro, 4 - kundër, 5 - abstenim, miraton sa më sipër.

V.K (V. Balli, E. Murataj, A. Kana, E. Muzhaqi)

V.A (Y. Balliu, B. Copja, E. Jaurri, D. Madhi, R. Mita)


Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



Mbajtëse e Procesverbalit

Selena Gjorga



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 25.06.2026, ora 01:16 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Elsid Zyma dhe Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Pika 3 e rendit të ditës

3. Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Maj 2026.

Këshilli Bashkiak me 31 vota pro, 1 - kundër, 3 - abstenim, miraton sa më sipër.

V.K (V.Balli)

V.A (D.Madhi, E.Murataj, E.Muzhaqi)

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala




Sekretar I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 25.06.2026, ora 01:16 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Elsid Zyma dhe Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Pika 4 e rendit të ditës

~~4. Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Maj 2026.~~

Këshilli Bashkiak me 31 vota pro,- kundër, 4 - abstenim, miraton sa më sipër.

V.A (D.Madhi, E.Murataj, E.Muzhaqi, V.Balliu)


Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 25.06.2026, ora 01:16 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Elsid Zyma dhe Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Pika 5 e rendit të ditës

5. Për dhënien në përdorim të fondit pyjor publik.

Shpëtim Cullhaj-Përfaqësues I Administratës Bashkia Elbasan

Kjo janë rinovime kontratash të antenave të telefonis celulare One të cilat janë në Fush-bull një antenë është 50 m² dhe një është 250m² që sipas procedurave kërkohet miratimi në Këshill Bashkiak për rinovimin me një afat 9 vjeçar të kësaj kontrate sipas lishencës që kompania ka marrë.


Këshilli Bashkiak me 26 vota pro, 2 - kundër, 7 - abstenim, miraton sa më sipër.

V.K (V.Balliu,E.Murataj)

V.A (Y.Balliu,B.Copja,E.Jaurri,A.Kana,R.Mita,D.Madhi,A.Mecja)


Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 25.06.2026, ora 01:16 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Elsid Zyma dhe Zv. Kryetari i Bashkisë Z. Asim Sula, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Pika 6 e rendit të ditës

6. Miratimi i programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 (faza e parë).

Shfaqet Bullari-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Në kemi miratuar vlerësimin e të ardhurave dhe tavanet përgatitore të shpenzimeve dhe faza e parë përcakton që është përfunduar janar-qershor dhe pasi bëhet publik I dërgohet ministrit të financave. Sot janë detajuar programet në mënyrë analitike ndërsa të ardhurat dhe shpenzimet mbeten po këto që kemi miratuar. Të ardhurat e Bashkisë shtohen me 2.5% çdo vit nga 2027, 2028, 2029 në raport me vitin paraardhës nga të cilat të ardhurat e bashkisë shtohen 2% dhe transferta pakushtëzuar 4.6 dhe 4.9 %, ndërsa transferta sektoriale 2% në 2027 dhe 1% 2028-2029 ka rritje. Shpenzimet e përgjithshme të personelit kanë një ulje prej 12% për vitin 2027 ndërsa 2028-2029 qëndrojnë të njëjtin nivel të 2027. Shpenzimet kapitale që janë investimet kanë një rritje prej 10% në dy vitet e para dhe 6% në vitin 2029 pra ka një shtesë të fondeve për investime që do të bëhen në territorin e Bashkisë. Ka një rritje të emergjencave civile prej 4.6-4.9% , programet e tjera kanë një rritje të ndjeshme mesatare që varjon nga 2-3% rritje. Programi buxhetor afatmesëm është një instrument I rëndësishëm I Bashkisë, është dhe bazë për parashikimin e çdo buxheri vjetor të Bashkisë. Kemi vetëm ndryshum të programeve buxhetore analitike.

Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

E kam parë tek email kam analizuar dhe ato më përpara që keni sjellë në Këshill Bashkiak miratimin e programeve buxhetore afatmesme, nëse ka një Bashkinë

republikën e Shqipërisë e cila flet shumë bukur në letra dhe dështon në projekte konkrete dhe në implementin të tyre olaneve buxhetore që bën nuk kam asnjë lloj dyshimi që është Bashkia Elbasan. Miratimi I këtij programi buxhetor për 2027-2029 do yë duhet që para se ta bënin këtë program ata që e kanë miratuar ti bënin pyetje vetes a do jenë apo jo në kushte që ta implementojnë. Ky program 2027-2029 do të bjeri jopër shkak të programit në vetvete po për shkak të hartuar dhe atyre që mnedojnë që do ta implementojnë unë dua ta mbyll fjalën time duke ju thënë që domishte mirë dhe në nderin e të gjithë atyre funksionarëve të ndershmë në Bashkinë e Elbasanit që të heqin dorë nga abuzimet.

Këshilli Bashkiak me 24 vota pro, 10- kundër, 0- abstenim, miraton sa më sipër.

V.K(V.Balliu,E.Murataj,Y.Balliu,B.Copja,A.Kana,R.Mita,D.Madhi,A.Mecja,
Z.Muzhaqi,E.Muzahqi)


Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 25.06.2026, ora 01:16 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Elsid Zyma dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Pika 7 e rendit të ditës

~~7. Për miratimin e akt-dhurimit të mjetit teknologjik (AUTOCARRO PËR~~
PASTRIMIN RRUGE SCANIA P114 VP1999) me tonazh 12.8 ton.

Këshilli Bashkiak me 24 vota pro, 5- kundër, 4- abstenim, miraton sa më sipër.

V.K (E. Murataj, Y. Balliu, B. Copja, A. Kana, E. Muzahqi)

V.A (E. Jaurri, D. Madhi, R. Mita, Z. Muzhaqi)


Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 25.06.2026, ora 01:16 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Elsid Zyma dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Të ndryshme.

1. Transferim fonde në buxhetin e Klubit Shumësportësh.

Zamir Muzahqi-Zv Kryetar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Nga ana procedurale u shpreh anëtari I Këshillit që, jo materiale të tilla gjysëm ore para mbledhjes. Unë kisha një pyetje për kryetarin na ka ardhur një fond për teatrin Skampa a jemi akoma në plan me rikonstruksionin e teatrit Skampa.

Gledian Llatja-Kryetari I Bashkisë Elbasan

Sic e kemi diskutuar kemi filluar procedurën për shpronësimin besoj se jemi të gjithë të njohur me Tetarin Skampa me një vendim gjykatë pra kemi bashkëpronësi ne Tetarin Skampa me privatët dhe kemi diskutuar bashkë për dy fakte e para për lirin e hapësirës të Tetarit Skampa që ka qënë ish lokali dhe rimbursimin e vlerës sipas vendimit të gjykatës dhe për rikonstruksionin e Tetarit Skampa. Në momentin që do të fillj rikonstruksionin ngrihet automatikisht vlera e investimit që bëhet por në fillim duhet bërë shpronësimi i subjekteve private dhe ne të vazhdojmë të kemi investimin në teatrin Skampa është projekti janë kryesor rimodelimi i tetarit Skampa në brëndësi të saj pa prekur fasadën dhe gjendjen e jashtë sepse është monument culture dhe nuk mund të ndërhyjmë tek fasada me dimensione të mëdha pra duhet të bëjmë risisteme dhe projekti është dhe po vazhdojmë me pkesën e procedurave që kemi hequr me procedurat e shpronësimit për të vazhduar dhe me pjesën e investimit. Deri tani në tetarin skampa nuk kemi bërë investime kapitale kemi bërë punime të brendshme mirembajtje për sistemet e ndricimit si dhe tani për sistemin e kondicionimit. rikonstruksioni i teatrit Skampa prioritet kryesor.

Këshilli Bashkiak me 27 vota pro, 1- kundër, 6- abstenim, miraton sa më sipër.

V.K(E.Murataj)

V.A (Y.Balliu,B.Copja,E.Jaurri,D.Madhi)


Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga



Sekretar I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma



PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 25.06.2026, ora 01:16 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan, ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi, Sekretari I Këshillit Bashkiak Z. Elsid Zyma dhe Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Altin Mecja-Anëtar I Këshillit Bashkika Elbasan

E kisha për problematikën e kanalit të ujit vaditës të Labinot-Fushë nuk ka pasur pothuajse fare gjithë këto ditë por e njeta gjë ndosh me me kanalin Naum panxhi në Kuqan është shumë problematik.

Gledian Llatja-Kryetari I Bashkisë Elbasan

Ka qënë dhe është ne e kemi pasur vaditjen prioritet kryesor kanali I Labinot-Fushës kemi gjetur një zgjidhje proviore der isa të mbaronte pjesa e kanalit na I desh për shkak të ndërhyrjes që është bërë në koridorin 8 të bëjmë një spastim jemi spostuar më shumë sec kemi qënë në vitet e kaluara është bërë një punë nga ndërmarrja e punëve publike për spostimin ajo ka mbaruar dhe uji është futur mbrëmë në kanal do të presim pjesëm e pastrimit që pastrohet kanali vet tek ojesa e tij dhe pastaj do të ndërhyet pjesa e pastrimit që është buzë autostardës, Naum Panxhi ka qënë funksionla ka pasur probleme për shkak të rreshqitje sidomas pjesa e Tudanit, ka pasur rrëshitje nga rreshjet dhe nga hedhja e inerteve por dhe aty është parashikuar që sapo të mbarojnë mjetet në Labinot fushë do të shkijnë të merren me pjesën e kanalit të Polis Studanit për pjesëne tudanit kurse pjesa tjetër e kanalit ka pasur problematika të vogla por ska pasur mungesa.

Ergys Muzhaqi-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Une jam banor I lagjes 5 Maji, në datë 1 Mars 2026, mbas 13 milion euro investimi Elbasani do të ketë 24 orë ujë, në lagjen time nuk ka ujë por marr ankesa nga qytetaret që nuk kanë ujë 24 orë. A mund të më thoni cilat lagje të Elbasnait sot që po flasim kanë ujë 24 orë dhe cilat nuk kane?

Gledian Llatja-Kryetari I Bashkisë Elbasan

Investimi I madh me KfV-në që është bërë me ujesjellsin ka mbaruar dhe më kantaktime të vazhdueshme që ujsjellësi ka bërë dhe me kontraktorët për të bërë

raportime sic I keni kërkuar ju kur I keni kërkuar, kanë pasur një kontrat ata për të zbatuar e cila ka mbaruar pjesën e investimit kapital janë tek pjesa e ndërprerjes të linjave të vjetra dhe tek vendosja e linjave të reja pra momentalisht nuk ka më investim është mbyllur pjesa e investimit janë pjesët e vogla, është bërë e mundur që në lagjen kala të vendosen pjesa e sahateve pasi një pjesë e mirë e lagjeve nuk ka pasur vendosje të sahateve, një pjesë e tyre është vendosur po presim nga banorët që të bëjnë lidhjet nëpërmjet sahatit pasi detyrimi igjor I ujësjellësit është detyrim I qytetarit që të bëjë lidhjen e vet brenda banesës së tij. Është përmirësuar ndjeshëm është bërë ndërhyrja në deot kryesore të qytetit ku është rritur jo vetëm kapaciteti por dhe cilësia e depove ka filluar zbatimin I projektit ku momentalisht janë tek rruga Arif Dardha ku aty ka pasur disa problematika për vendosjen e linjës së që të funizohet me ujë, janë duke punuar nuk e kanë mbyllur akoma tërësisht vendosjen e linjave të reja pra mbylljen përfundimtare me banesat kanë mbaruar punën civile të cilët kishin detyrimet ligjore I kanë mbyllur tani janë duke punuar për lidhjet dhe për ndërprerjet e zonave të vjetra.

Ergys Muzhaqi-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Pra 4 muaj pas prentimit që do të kemi 24 orë ujë në qytet cilat lagje kanë 24 orë ujë se nga përgjigjja juaj asnjë nga lagjet nuk ka 24 orë ujë.

Gledian Llatja-Kryetari I Bashkisë Elbasan

Për informacinë që kërkon do të lidhemi me ujësjellësin kur e kanë përfunduar dhe ku ka arritur që të futet sistemi unazor I rid he të vihen depot në funksion në të gjitha ato lagjet që futet sistemi unazor I ri ka përmisim të cilësisë dhe orareve të ujit.

Ergys Muzhaqi-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Pra ju nuk keni përgjigje se cilat lagje kanë 24 orë ujë sot që ne flasim.

Gledian Llatja-Kryetari I Bashkisë Elbasan

Jnë Akoma duke punuar duke prerë linjat e vjetra, javës që kaloi kanë qënë duke prerë linjat e vjetra pranë shkollës Naim Frashëri, dhe tek rruga Jasharit dhe ato po pritëtn linjat e vjetra në mënyrë që sistemi I ri unazor të marri funizimin me ujë.

Erion Murataj-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Një student që nuk kishte mësuar gjithë vitin ditën e provimit vendosi që të mësojë lëndën e biologjisë dhe kur vajti në provim I ra peshku për ta analizuar dhe tha

peshku nuk është gjitar sepse po të ishte gjithar do të kishte qime dhe morra dhe filloi të shkruantë prap për morrin (largohet nga salla)

Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Meqë jemi tek të ndryshmet, dua të ngreh një çështje që ti thërrasvëmendjes së të gjithëve dhe të kryetarit dhe të cdo vendimarrësi duhet të jemi të vëmëndëshëm për situatën që po kalon vendi si vendimarrës për aq sa na takon. dhe në vazhden e kësaj që po them dhe në situatën politike dhe po atë shoqërore ku njerëzit kanë dalë në protest duke kërkuar me të drejtën e tyre për ato që ata mendojnë dhe padrejtësitë që I janë berë mbi 35 vjet doja ta lidhja me paketën e maleve ato kanë fshirë dhe anulimin e ligjeve të oaketës së maleve që nuk është në tagrin e këtij këshilli në tagrin tonë është vendimarrja për aq sa na takon që a përcakton ligji për atë pjesë që ligji na lejon dhe atë verifikim që duhet të bëjmë për personat që I marrin dhe marr shkas për këtë që them dhe ju pergëzoj që e keni hequr nga rendi I ditës sot paketën e maleve porn ë mbledhjen e kaluar ju kaluat disa persona dhe ju sugjeroj që do të jetë në nderin tuaj dhe në nderin tonë do tju kërkoja miqësisht që të na jepni informacion të plotë për aq sa kërkohet që ne të miratojmë prej përsoneve që përfitojnë nga paketa e maleve. Të jenë të gjithë të ndarë që të mosj I hyjmë në hak të gjithë atyre banorëve që e meritojnë që midis atyre banorëve që e meritojnë kalojnë dhe disa të tjerë që nuk e meritojnë. Është në nderin tonë që të mos I hapim më konflikte pronësie ktij vendi.

Doris Madhi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Përpos faktit që jam dakord me këshilltarin Kana do të ishte mirë që kto dosje të vinin të ndara me dokumentacionin përkatës. Dua vetëm të precizoj dhe të sqaroj për të disatën herë që për qytetarët kjo, nuk jemi ne personat që bëmë dikë përfitues të paketës së maleve ne jemi një hap përpara aplikimit të paketës së maleve duhet sqaruar kjo sepse shumë njerëz mendojnë që jemi ne që nesër kemi të drejtën ti bëjmë përfitues të kësaj ne I japim statusin e poseduesit jo pronarë prat ë atij personi që është në përdorim dhe në zhvillim të terrenit të caktuar, aplikimi bëhet tek ministria përkatëse apo në ealbani. Faleminderit.

Gledian Llatja-Kryetari I Bashkisë Elbasan

Unë nuk kisha mundësi të sha tek mbledhja e kaluar tek e cila doja të isha vet të sqaronim paketën e maleve, është ajo që thotë zonja Madhi që ne jemi një hallkë e verifikimit të poseduesit jopronarë pra nne kemi shumë toka sot të zëna të zabtuara të mbjella prej 20 vitesh 30 vitesh kryesisht janë mbi 10 vite të cilat janë mbjellë

në mënyrë të pandërprerë I aknë përdorur ato për qëllime të veta ekonomike të familjes së tyre dhe duan të zhvillojnë një agroturizëm apo të zhvillojnë një bujtinë në këto ambjentë. Janë toka të cilat I kanë pranë banesave të tyre dhe automatikisht në zona të caktuara që kanë marrë dhe legalizimin nuk e kanë marrë të gjithë pjesën e pronësisë që kanë pasur por kanë marrë vetëm atë sipas ligjit për legalizimin apo kanë pasur një sipërfaqe toke që të gjithë e dinë, që e ka pasur të vetën brezash por nuk e ka pasur me dokumentacinin përkatës dhe kanë kërkuar tani që të zhvillojnë agroturizëm, efektë turistike ambjentet e tyre toka që I kanë të zëna dhe pronarë të cilët I kanë pasur I kanë poseduar si toka të të parëve kryesisht në zonat malore ku të gjithë e dinë që ka qënë e tyre dhe nuk ka pasur problematika për zonën e fashatit sepse të gjithë kanë marrë vërtetimin nga komuna, pleqësia nga administratori janë bërë shpalljet publike përkatëse ato e kanë ato kanë vërtetuar me dokumentacion të vjetër që e kanë pasur si pronë dhe sot me këtë paketë malesh I ka lindur e drejta të njihen si posedues jo pronarë në fakt që duhet tja kishte njohur prej kohësh legjislacioni, ajo që I ka bërë legjislacioni përkats I ka dhënë atyre ë drejtën ta zhvillojnë, dhe në moment që bëjnë investimin ta marrin pronësinë e tyre sipas legjislacionit në fuqi. Nuk bëhet ktu aplikimi për ndërtim nuk bëhet tek ne, ne jemithjesht hallka që njohim poseduesin jo pronarë sepse ne jemi pushteti vendor dhe këshilli bashkiak në thelb miratin atë që ka miratuar fshati, ka pritur 45 ditë për pjesë e ankimit me shpalljen publike në faqen zyrtare të Bashkisë Elbasa, në këndin e njoftimeve pranë Bashkisë Elbasan dhe pranë njësisë administrative përkatëse kjo është procedura e ndjekur ligjërisht. Atij që I takon sipas ligjit ne nuk mund tja mohojmë dot të drejtën që ta njohim si posedues jo pronarë ne kemi pasur prej vitesh posedues jo pronar tek muzeu Aleksandër Xhuvani, të njohur në hipotekë, ato që kanë qënë posedues jo pronarë prej vitesh është gjë e mirë që të njihen nga Këshilli Bashkiak sic I njeh fshati, komuniteti lokal, nëse ato nuk vazhdojnë me pjesën e investimit dhe me të gjithë proceduar e tjera ligjore nuk e përfitojnë më këtë status.

Altin Mecja-Anëtar I Këshillit Bashkika Elbasan

Kjo paketa e maleve, ne pyjet nuk I kemi me letra më thuaj mua një në të gjithë rrethin e Elbasanit që është me dokumenta, ne pyjet I kemi ndarë pa dokumentacione, që do të thotë që ai që do të vi do marri pyllin tim direct mas shpisë time për mua kjo është vazhdo e ligjit 7501.

Gledian Llatja-Kryetari I Bashkisë Elbasan

Unë e kuptoj pjesën politike të gjësë,në momentinqë bëhet një ankesë procedura anulohet ë thotë ligji,porn ë momentin ku I gjithë fshati se un nuk jetoj në fshat atje është një komunitet lokal I fshatit që ka rregullimin e vet me pleqësin e tij me kryeplakun e vet dhe ato në momentin që nuk ka ankimim nga komuniteti të gjithë janë dokard dhe e kanë pranuar atë fakt dhe e ka poseduar këtë pronë prej shumë vitesh do ta zhvillojë dhe ka dis dokumenta të vjetra ato që e kanë marrë atë pjesë kanë të tilla dhe nuk ka probleme me fisin me kushuririn në momentin që ka një ankesë procedura pezullohet.Tek pylli I gështenjave ju e keni ndarë dhe I keni marrë të mirat pyllit.

Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Unë I besoj fjalës dhe asaj që ju keni qëllim të mirë por kur shikoj që ne si këshillrat nuk na vjen një dokumentacion I plotë dhe shterues I cili vërteton që ky person posedon prej kaq vitesh atë pronë sepse na dolën që tek ajo lishta aty disa perosna janë 23 vjec dhe para 10 vjetësh kanë qënë 13 vjec,si mundet një vajzë 13 vjece të ketë në posedim një tokë.Kjo ngre pikëpyetje kur shikon emrat dhe moshat që kanë dhe mungesa e dokumentacionit yë shton Akoma më shumë dyshimin.Nëse ju do të kishit bërë detyrën tuaj pëe aq sa ju takon ligji se ne aq kemi në dorë si këshilltar të miratojmë ato që kanë sjellë banorët se në as nuk I njohim kush janë banorët në gjinar dhe nuk dua që ti kundërvihem banorëve që të përfitojnë nga toka sic përfitojmë ne në qytet është e drejta e tyre por unë si këshilltar dua të kem një dokumentacion të plotë që është ezaurues për sa I përket afatve ligjore që janë respektuar,konsuktimit publik që nuk ka konflikte,banorët janë dakord,dokumentin që e posedon prej 10 vitesh.Plotësoni dokumentacioni dhe ndashta dhe unë e votoj pro.

Gledian Llatja-Kryetari I Bashkisë Elbasan

E ka pasur nga familja.Me sa di unë ky është një shqetësim I ngritur dhe tek mbledhja e kaluar dhe mesa di unë administata duhet tjuja ketë vënë në dispizicion në mbledhjen e komisioneve të gjithë dokumentacionet origjinale pra dosjen e plotë.Nëse sjeni njohur në komision janë të gjitha dokumentat aty,sot nuk e keni futur paktën e maleve.

Shpëtim Cullhaj-Përfaqësues I Administratës Bashkia Elbasan

I kemi sjellë të gjithë dokumentacionin që ju duhet.

Doris Madhi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Në të gjithë këtë procedurën e njohjes të poseduese jopronarë ka raste që shpeshherë qytetari nuk është në dijeni të bzës ligjore ,rasti në fjalë që po flistë këshilltari Kana bëhet fjalë për një baba që ka tentuar të vetërregulloj statusin e poseduesit jopronarë duke i transferuar vajzës së tij një pjesë që ai posedon aktualisht.Unë mendoj që kjo qytetar duhet të kenë dhe një farë asistence ligjore kur bëjnë kjo lloj aplikimesh në mënyrë të tillë që mios hasim nga kjo lloj vështirësish sin ë rastin konkret që vajza rezultonte minorena 10 vite para.Kjo janë raste të vogla që mund të rregullohen mjafton të vihej toka në emër të babait dhe pastaj e bënte ndarjen mbrapa.Nsërsa për raste të tjera të vecanta ju lutem nga sot dhe në vazhdim dokumentacioni duhet të jetë i detajuar ashtu sic e keni parë ju jo me relacione të shkurtuara.Faleminderit.

Gledian Llatja-Kryetari i Bashkisë Elbasan

Të gjitha materialet duhet të jenë të plota dhe tju vihen në dispozicion nëse ka të dhëna konfidenciale të paktën në komision të jepen.Të gjitha të dhënat të jepen nuk ka asgjë sekrete,janë të gjitha në Bashki.Faleminderit.

